



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 18 të Udhëzimit administrativ nr. 06/2018, për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, nenit 13 të Udhëzimit administrativ, nr. 04/2018, për transparencë në komuna, nenit 32, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 02.05.2019, merr këtë

V E N D I M **PËR KONSULTA PARAPRAKE PUBLIKE**

I.

MIRATOHET Vendimi për lënie në shqyrtim publik të Projektregullores për themelimin dhe strukturimin e Asamblesë komunale të fëmijëve.

II.

Lidhur me rregulloren e cekur në pikën I, Komisioni do të ofrojë informata të nevojshme për opinionin-qytetarët e interesuar, përmes formave të fushatave informative, kontakteve me grupe të interesit dhe palët e interesuara për t'i diskutuar propozimet.

III.

Konsultat paraprake publike për Rregulloren e cekur në pikën I të këtij vendimi, do të zgjasin 30 ditë.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen, Kryetari i Komunës dhe drejtoritë tjera kompetente.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-030/01-0101109/19, më 03.05.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta